# KOMUNA E JEGUNOVCIT

# FLETORJA ZYRTARE
## E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

| | | |
|---|---|---|
| **Botohet sipas nevojës** | **Numër 37** | **19.04.2024** |

**JEGUNOVC, P R I L L 2024**

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për caktimin e vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore

**Shpallet** Vendimit për caktimin e vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/1
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM',nr. 5/02) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03),kurse në pajtim me nenin 78 paragrafi 1 të Kodit zgjedhor ("Gazeta zyrtare e RM',nr. 40/06.....27/19 dhe "Gazeta zyrtare e RMV'',nr. 98/19.....58/24),Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2023 ,mori

# VENDIM

**për caktimin e vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore**

Neni 1

Me këtë Vendim caktohen vendet për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, në territorin e Komunës së Jegunovcit.

Neni 2

Vendosja e afisheve zgjedhore gjatë kohës së fushatës zgjedhore lejohet të vendosen, pa kompensim edhe atë:

- nëpër shtyllat elektrike dhe ato të telefonit;
- në tabelat informuese nëpër vendbanimet

Secili bartës i listës veçmas ka të drejtë shfrytëzimi të vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore nga paragrafi 1 i këtij neni në çdo shtyllë të shtatëmbëdhjetë.

Neni 3

Dëmtimi i afisheve zgjedhore ose ngjitja e afisheve mbi afishe të organizuesve të tjerë të fushatës zgjedhore është e ndaluar.

Neni 4

Organizuesi i fushatës zgjedhore është i obliguar që në afat prej 30 ditësh pas mbarimit të zgjedhjeve që ta largojë bërllokun e afisheve.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes dhe do të publikohet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit" dhe në tabelën për shpallje të Komunës.

Nr. 08-738/3
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje

**Shpallet** Vendimi për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/2
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02), kurse në pajtim me Ligjin për plotësimin e Ligjit për rrogat dhe kompensimet e tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë („Gazeta zyrtare e RSM „ nr. 36/90 dhe Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 38/91,23/97,37/05,84/05,121/07,161/08,92/09,42/10, 97/10,161/10, 11/12, 145/12, 170/13, 139/14, 233/18 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së„ nr. 51/23, 65/23 dhe 51/24), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024 mori:

# VENDIM

## për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet kompensimi mujor për anëtarët e Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit.

Neni 2

Kompensimi mujor për anëtarët e Këshillit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e saj vërtetohet në shumë prej 40% nga rroga mesatare neto mujore në RMV e paguar vitin e kaluar.

Kompensimi mujor i anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit është 14.645 denarë.

Neni 3

Kryetarit të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për udhëheqjen dhe organizimin e punës së Këshillit kompensimi nga neni 2 i këtij Vendimi rritet për 30% dhe do të jetë 19.039 denarë.

Neni 4

Kompensimi mujor nga neni 2 I këtij Vendimi për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit paguhet për pjesëmarrje në të gjitha mbledhjet e Këshillit për muajin rrjedhës.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit zvogëlohet për 30% për çdo mungesë nga mbledhja e Këshillit.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit nuk paguhet nëse anëtari i Këshillit nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje të Këshillit gjatë muajit rrjedhës.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhje nuk do të paguhet nëse Këshilli në muajin rrjedhës nuk do të mbaj mbledhje.

Neni 5

Anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit do t'ju paguhet kompensim për harxhime rruge dhe ditore për udhëtime zyrtare në vend dhe në botën e jashtme sipas dispozitave të cilat u përkasin nëpunësve shtetëror, të punësuar në administratën komunale të Komunës së Jegunovcit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit"kurse do të zbatohet nga prilli 2024.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi ndërpritet të vlejnë Vendimi i Këshillit nr. 08-781/3 të datës 11.05.2023 ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit", nr. 24/2023).

Nr. 08-738/4
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska, d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024

**Shpallet** Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/3
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafit 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së",nr. 5/2002) , nenit 91 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit "nr. 21/03) dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 pika 1 të Ligjit për ndryshimin e ligjit për rroga dhe kompensime të tjera për personat e zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë (''Gazeta zyrtare e RMV-së",nr. 51/24), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024, mori:

# V E N D I M
## për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024

### Neni 1

Në Vendimin për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 nr. 08-2053/7 të datës 27.12.2023 („Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit nr. 32/2023) dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 nr.08-178/3 të datës 29.01.2024 („Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit nr. 34/2024) , në nenin 9 paragrafi 1 alineja 1 ndryshohet dhe thotë:

- kueficienti për pagesën e rrogës së kryetarit të komunës është përcaktuar me ligj, dhe është 2,35, baza e përllogaritjes së pagës është paga mesatare mujore e paguar për të punësuar në Republikë për vitin paraprak, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës

### Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-738/5
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska,d.v

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# A K T V E N D I M

për shpalljen e Programit për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024

**Shpallet** Programi për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/4
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 Ligjit për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse ( Gaz. zyrtare e RM.-së nr. 66/04, 139/08, 99/09, 149/14, 150/15 dhe 37/16) dhe ( Gaz. zyrtare e RMV.-së nr. 257/20) dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024 mori:

**P R O G R A M**

**për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024**

Kompetencat e komunës për miratimin e Programit për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e saj, dalin nga neni 64 paragrafi 10 të Ligjit për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse ( Gaz. zyrtare e RMV.-së nr. 257/20).

Qëllim kryesor i kësaj programe është mbrojtja e popullatës nga sëmundjet ngjitëse, e njëjta planifikohet të zbatohet me realizimin e masave të përgjithshme të cilat do të zbatohen në pajtim me standardet dhe procedurat të përcaktuara me ligj.

Në organizimin dhe zbatimin e masave të përgjithshme komuna bashkëpunon me kompetentët ESHP Qendra për shëndet publik.

1. Qëllimet

    1. Parandalimin e paraqitjes dhe përhapjes së sëmundjeve ngjitëse
    2. Sigurimin e ujit të pastër dhe të shëndetshëm për pije
    3. Mbrojtja e të gjitha grupeve të popullatës nga sëmundjet ngjitëse
    4. Reduktimi i popullatës së mushkonjave dhe insekteve tël tjera të imëta në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe sjelljen e tyre në nivelin e tolerancës biologjike

2. Aktivitete

Aktivitetet e cekura në Program janë në pajtim me dispozitat ligjore në të cilën janë të definuar detyrimet e komunës të cilat duhet të ndërmerren që të arihen qëllimet e shënuara më lartë.

| **Nr. rendor** | **Aktivitete** | **Afati** | **Bartësi** | **Burimi i mjeteve** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Dezinfektim, dezinsektim dhe deratizim | | Komuna e Jegunovcit- ESHP Qendra për shëndet publik | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |
| 1.1. | Analiza në terren e realizimit të dezinfektimit, dezinsektimi dhe deratizimit | Muaji mars, prill | Komuna e Jegunovcit | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |
| 1.2. | Dezinsektimi në territorin e Komunës së Jegunovcit<br>- Para f. Siriçinë deri në f. Tudencë përgjatë rrjedhës së lumit Vardar ka gërmime të rërës në të cilat ka uji që nuk rrjedh.<br>- Në mes të f. Shemshovë dhe f. Prelubishtë ka vise malore me këneta në gjatësi prej 300m dhe gjerësi 100 metra<br>- Në mes të f. Prelubishtë dhe f. Jançishtë ka vise me këneta në gjatësi prej 2500m dhe gjerësi 400 metra e cila gjendet më | maj, qershor, korrik dhe gusht | Komuna e Jegunovcit- ESHP Qendra për shëndet publik | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | larg nga rruga rajonale.<br>- Nën vendbanimin f. Jegunovc shtrihen vise me këneta në pjesën kah f. Podbreg me gjatësi prej 800 m dhe gjerësi 200 m.<br>- Nga v.b. Jegunovc deri në v.b. Raotincë ka vise me këneta(palenik) nëpër të cilin kalon udhë ilegale, ka deponi komunale, nëpër të cilën kalon lumi Bistrica.<br>- Nga v.b. Raotincë deri në v.b. Jançishtë ka vise me këneta<br>- Nëpër Ratajë kalon kanal i hapur i cili ka shërbyer për ujitje i quajtur Radiovc-Bistricë i cili nuk funksionon dhe në të derdhet mbetje fekale<br>- Nën f. Vratnicë në mes të f. Nerashtë dhe Orashje ndodhet Liqeni artificial i Vratnicës. | | | |
| 1.3. | Marrja e masave për dezinfektim e të gjitha shkollave në territorin e Komunës së Jegunovcit | Dy herë brenda vitit | Komuna e Jegunovcit-ESHP Qendra për shëndet publik | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2. | Analiza e rregullsisë higjienike e ujit për pije | Brenda gjithë vitit | Komuna e Jegunovcit | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |
| 2.1. | Ndjekja e rregullsisë higjienike të ujit nga Ujësjellësi rajonal | Brenda gjithë vitit | Komuna e Jegunovcit | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |
| 2.2. | Marrja e masave për pastrimin e ujit për pije në ujësjellësin rajonal (klorim) | Brenda gjithë vitit | Komuna e Jegunovcit | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |
| 3. | Informim i publikut | Brenda gjithë vitit | Komuna e Jegunovcit | Buxheti i Komunës së Jegunovcit |

**3. Financimi**

Mjetet e programit do të sigurohen nga buxheti themelor i Komunës së Jegunovcit konform mundësive reale financiare për masat e shënuara në program nën pikën 1.1, 1.2, 1.3 dhe pikën 3 ndërsa për pikat 2.1 dhe 2.2. do të sigurohen mjete nga buxheti i NP Jegunovci f. Jegunovc.

4. Lajmërimi

Lajmërimi dhe informimi i qytetarëve do të bëhet përmes Lajmërimeve të vendosura në vende të dukshme publike, ueb faqes së komunës, mediumeve lokale, bashkëpunimi i komunës me Bl, shoqatat e bletarëve etj., për kohën e saktë të aksionit, llojit të preparatit dhe mënyrën e realizimit.

Ky Program hyn në fuqi në ditën e shpalljes në „Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit''.

Nr. 08-738/6
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Valentina Marçevska,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# AKTVENDIM

për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2024

**Shpallet** Konkluzioni për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2024, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/5
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/02) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit",nr. 21/03), kurse në pajtim me nenin 32 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së"nr 61/2004, 96/2004, 67/07,156/09, 47/2011, 192/15, 209/2018 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së"nr. 244/19, 53/21, 77/21, 150/21), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024, mori

# KONKLUZION

**për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2024**

1. Miratohet Raporti financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2024.

2. Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-738/7
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024

**Shpallet** Vendimi për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 , që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/6
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/02) lidhur me nenin 34 të Ligjit për Buxhetet ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 64/05, 4/2008,103/2008, 156/2009, 95/2010, 180/2011, 171/2012, 192/15 he 167/16 dhe "Gazeta zyrtare e RMV" nr.151/2021 ), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024, miratoi

# V E N D I M
## për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024

### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi i shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024 edhe atë në këtë mënyrë:

| Nënprogrami<br>Nënzëri | Buxhet | vetëfinancim | dotacione | donacione | Kredi |
|---|---|---|---|---|---|
| **E00 ADMINISTRATA KOMUNALE** | | | | | |
| 427110 Punësime të përkohshme | 800.000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **LA0 SPORT DHE REKREIM(SHPENZIME KAPITALE)** | | | | | |
| 482920 Ndërtimi i objekteve tjera | -800.000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

### Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit" dhe bëhet pjesë përbërëse e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.

Nr. 08-738/8
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska,d.v

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

# AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për ndarjen e ndihmës financiare

**Shpallet** Vendimi për ndarjen e ndihmës financiare, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 18.04.2024.

Nr. 09-755/7
19.04.2024
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e tridhjeteshtatë të mbajtur më 18.04.2024 e shqyrtoi kërkesën e Snezhana Nikoliq nga f. Jançishtë dhe mori,

# VENDIM
## për ndarjen e ndihmës financiare

Neni 1

Nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit për Snezhana Nikoliq nga f. Jançishtë ndahet ndihmë e njëhershme financiare në shumë prej 5.000 den.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni ndahen si ndihmë financiare për sanimin e dëmeve të cilat u shkaktuan nga zjarri i cili shpërtheu më datë 06.03.2023 në shtëpinë e saj familjare në f. Tudencë..

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-738/9
18.04.2024
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Valentina Marçevska,d. v .

P ë r m b a j t j a

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për caktimin e vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore.....1
Vendimi për caktimin e vendeve për vendosjen e afisheve zgjedhore pa kompensim gjatë kohës së fushatës zgjedhore.....2

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje.....3
Vendimi për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje.....4

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....6
Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....7

Aktvendimi për shpalljen e Programit për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....8
Programi për zbatimin e masave të përgjithshme për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse në territorin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....9

Aktvendimi për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin e I-rë të vitit 2024.....13
Konkluzion për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin e I-rë të vitit 2024.....14

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....15
Vendimi për ndryshimin e shpërndarjes së mjeteve në Buxhetin e Komunës së Jegunovcit për vitin 2024.....16

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për ndarjen e ndihmës financiare.....17
Vendimi për ndarjen e ndihmës financiare.....18

Përmbajtja.....19